



Besart Berisha ka ndermend te rikthehet ne Europe. Sulmuesi qe po i cmend te gjithë ne Australi eshte zotuar se shume shpejt do te gjej nje skuader te madhe ne Angli ose Gjermani per te vazhduar karrieren. Nje lajm te tille Besarti e ka komunikuar per mediat kosovare. “Eshte e vertete se kohen e fundit kam shenuar shume gola, por dua te them se qe nga ardhja ime ne Australi jam ndjere mjaft mire, si une ashtu edhe familja ime. Mbase goli i shenuar kunder Manchester Unitedit me ka motivuar edhe me shume. Eshte e vertete se mendoj te kthehem ne Evrope edhe per shkak te perfaqesueses se Shqiperise. Kam disa oferta, por ende nuk ka diçka konkrete. Kam pasur biseda me skuadra te Anglise dhe Gjermanise, por momentin mbetem ne Australi. Me vone te shohim”, ka deklaruar Berisha.